

VENDIM
Nr. 194, datë 9.3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 223, DATË 19.4.2006, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGESËN E SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53 e 55, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 223, datë 19.4.2006, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 2 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“2. Personave, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, u paguhet e ardhura e papunësisë, në varësi të periudhës së kontributit të sigurimit shoqëror, përkatësisht për:
 - a) 3 muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, një vit;
 - b) 9 muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 5 vjet;
 - c) 12 muaj, për personat me një periudhë kontributi mbi 10 vjet.”.
2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:
 - a) Në shkronjën “b”, fjalët “...Certifikatë personale me fotografi...” zëvendësohen me fjalët “...Dokument identiteti...”; - b) Shkronja “P” shfuqizohet.
3. Pika 4 shfuqizohet.
4. Shkronja “a”, e pikës 11, shfuqizohet.
5. Pika 12 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“12. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi